



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL - LIPJAN
DREJTORATI I INSPEKTORATIT



DREJTORATI I INSPEKSIONIT

Datë :	04.08.2025
Referencë	11-344/7
Për :	Imri Ahmeti-Kryetar i Komunës
Kopje:	Diamant Bytyqi-Nënkryetar i Komunës
Kopje:	Lulëzim Qerimi-Nënkryetar i Komunës
Nga:	Flamur Sylejmani-Drejtori i Inspeksionit
Lënda :	Raporti i muajit-korrik

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Gjatë muajit korrik Drejtoria e Inspektoratit ka ndjekur agjendat e caktuara dhe ka realizuar inspektime të ndryshme në kuadër të kompetencës, duke përfshirë të gjitha lokalitetet në territorin e Komunës tonë.

Inspektorët e tregut- gjatë muajit korrik në fokus kishin inspektimin i lokaleve afariste. Janë realizuar urdhëresa për regjistrim të lokaleve dhe urdhëresa për pranime teknike të lokaleve afariste.

Janë organizuar kujdestari ku inspektimi është bërë në sheshin “Adem Jashari” në Lipjan, janë kontrolluar shitësit jashtë tregut, po ashtu gjatë kujdestarisë janë inspektuar disa veprimtari legale në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” të dhënies me qera të veturave për pasagjerët të cilët e frekuentonin Aeroportin.

Kontrollim i vazhdueshëm i tregjeve, në tregun e gjelbër janë urdhëruar të gjithë tregtarët të cilët kanë qenë jashtë hapësirës së tregut ty hynë në hapësirat e tregut, si dhe tregu i mobileve dhe ai i kafshëve.

Inspektori i ambientit-mjedisit-Sipas ankesave të pranura është bërë kontroll në vendngjarje si në: Lipjan, ku ankesat kishin të bëjnë për rrjedhje të ujerave të lëshuar gjatë larjes së ballkoneve, rrjedhje të ujarëve nga banjot dhe dëmtim të pronës si pasojë e defekteve, pengesa për vendosje të klimave, ventilatorëve për ajrosje në objektet në bashkëpronësi, pastaj në fshatin Dobrajë e Madhe për mbyllje të pusëtës ku gjenden valvulat e ujit të pijes nga një marketë ushqimor gjatë rregullimit të parkingut për konsumatorë, gjithashtu një marketit ushqimor në Dobrajë të Madhe është bërë rikontrollë sipas urdhëresës të dhënë kohë më parë për rregullim të vendit për kontejnerë. Është bërë rikontrolle një furre të bukës në Gadime e Ulët për shkak të ankesave së bëhet zhurmë gjatë natës nga furra. Furra ka zbatuar urdhëresën e dhënë, i ka bërë matjen e nivelit të zhurmës gjatë punës, nga operator të licencuar, dhe raporti tregon se nuk ka tejkalim të zhurmës. Gjatë kontrollave për secilin raste është konstatuar gjendja në procesverbal, janë dhënë urdhëresa për sanimin e shkeljeve ligjore. Në të gjitha rastet është bërë rikontrollë, dhe është vërtetuar se urdhëresat janë zbatuar.

Janë inspektuar disa deponi ilegale të mbeturinave, në fshatrat Sllovi, Akllap, Gadim e Ulët, rrugën për në fshatin Rubovc për të marrë masa ligjore ndajë ndotësve të cilët takohen apo gjeten dëshmi për ndotjen të mjedisit

Janë bërë kontrollat, tek objekti banesor në ndërtim e sipër në Lipjan, në rr. “Avdi Kelmendi” në lidhje me zbatimin e kushteve të lejes mjedisore komunale, gjatë kontrollave nuk u gjeten ndonjë parregullsi.

Një biznesi në Rr. “Shën Flori” për shkak të mbeturinave të lëna në hapësirë të përbashkët i është dhënë urdhëresë për dorëzim të mbeturinave K. Pastrimi. Pas rikontrollës u pa se biznesi kishte zbatuar urdhëresën.

Inspektorët e trafikut- Objektivë e inspektoreve të trafikut ka qenë inspektimi i kompanive të autobusëve, auto-taksive, radio-taksiv si dhe kombi-taksi ilegal.

Kompanitë e autobusëve janë inspektuar për rend të udhëtimit është bërë verifikimi i orarit të punës dhe janë urdhëruar firmat që të respektohet rendi i udhëtimit ashtu si është lëshuar nga organi kompetent.

Gjatë kujdestarisë në Aeroportin Ndërkombëtarë “Adem Jashari” është bërë inspektimi i radio-taksive që marrin pasagjer pa porosi dhe auto-taksit ilegal, po ashtu janë inspektuar disa kompani të radio-taksit si Roberti, Shoferi Im, Teslla, Victoria, Onllaini të cilët kishin licenc dhe merrnin udhëtar vetëm me porosi.

Inspektimi në bashkëpunim me Policin njësoja në Lipjan për kontrollimin e shenjave të trafikut se a kanë dukshmëri dhe a janë të mjaftueshme për orientimin e shofere në të gjitha rrugët brenda qytetit.

Inspektori i ndërtimit- Përgjatë muajit korrik inspektori i ndërtimtarisë ka inspektuar objekte të ndryshme ndërtimi në teren, e sidomos përgjatë zonës urbanistike, industriale, ekonomike. Me procesverbal është evidentua dhe konstatuar për të gjitha ndërtimet me leje ndërtimi dhe ato pa leje ndërtimi. Ndaj ndërtimeve pa leje janë realizu të gjithë hapat procedural ligjor.

Drejtoria e Inspektoratit është përgjegjur në të gjitha ankesat e pranuar nga qytetarët në formë të shkruar, elektronike apo përmes telefonatës.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUdhËS RAPORTUESE

Punët dhe aktivitetet e realizuara gjatë muajit korrik janë:

Janë realizuar urdhëresa për pranime teknike të lokaleve afariste si dhe janë bërë pesë pranime teknike te lokaleve afariste.

Ndalimi i shitjes jashtë tregut.

Inspektimi dhe parandalimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore dhe inspektimi i objekteve me leje ndërtimi.

Vendosje të shiritave zyrtar.

Gjoba mandatore.

Aktvendime.

Kallëzim penal

Inspektimi-kontrollimi i firmave të autobusëve në qytet dhe fshatrat.

Inspektim i rrugëve dhe trotuareve në qytet dhe jashtë qytetit.

Inspektimi i auto-taksive në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” në Vrellë.

Inspektim për kushtet e LMK-së dhe zbatimin e tyre ndaj investitorëve të objekteve me shumë njësi banimi.

Shqyrtimi i ankesave të qytetarëve në teren me kohë sipas ligjeve dhe rregulloreve komunale.

STATISTIKAT

Inspektorët	Gjithsej inspektime	Inspektime me procesverbal	Pranime teknike	Fletëparaqitje	Njoftime nga DPMUMM-ja	Kontrolla për leje Mjedisore komunale	Vendosje të shiritave	Vërejtje, njoftime	Punë me palë, ankesa , kërkesa	Lendet e pranuar	Lende te pezulluara, ekzekutuara gjyqësore	Konfiskim i targave, librezës dhe kthim	Gjoba mandatore	Te hyra nga pranime teknike	Inspektim i bizneseve pa pranime teknike	Menaxhim i tregjeve	Aktivendime, ndalesa, urdhëresa	Kallëzim penal	Inspektim me polici	Inspektim i bizneseve pa regjistrim
Biznesi	273	16							208	18			1			12	10			8
Ambienti	34	10				1		2	10								9		2	
Ndërtimi	60	18			16		1		5	18			1					1		
Trafiku	63	18						24	8							10			3	
Gjithsej	430	62			16	1	1	26	231	36			2			22	19	1	5	8

DISKUTIMET PUBLIKE

Diskutime publike nuk kemi mbajtur.

TAKIME TË TJERA

Takimet janë mbajtur me pronar të bizneseve, pronar të ndërtimeve, me taksistë dhe qytetarë të tjerë.

SFIDAT

Inspektimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore.

Inspektimi i bizneseve të paregjistruara, pa pranime teknike.

Ndalimi i hedhjes së mbeturinave inerte në tokat bujqësore, mbrojtja e hapësirave gjelbëruese.

Inspektime të auto-taksive, firmave të autobusëve në qytet dhe në fshatra si dhe inspektimi i taksive ilegal në ANP.

REKOMANDIMET

Rekomandojmë qytetarët të cilët hasin në ndonjë parregullsi e cila trajtohet me kompetencë nga Inspektorati Komunal të na njoftojnë në Drejtorin e Inspektoratit.